



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:100194
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05740868

K.DH.Shk II.nr.558/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “AlbiSoft GmbH”, dega në Kosovë, rruga “Ukshin Kovaçica”, Blloku C-12, Llam-A, Kati nr.1 Prishtinë, kundër debitorit “KiriTrees Plantage” SH.P.K, rruga “Ukshin Kovaçica” nr.11 Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.554/23 të datës 26.10.2023, me datë **28.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “AlbiSoft GmbH”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.554/23 të datës 26.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.554/23 të datës 26.10.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “KiriTrees Plantage” SH.P.K, rruga “Ukshin

Kovaçica” nr.11 Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.46/23 të datës 16.03.2023 të nxjerrë nga Përmbarruesi Privat Eset Murati, me seli të zyrës në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.554/23 të datës 26.10.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “AlbiSoft GmbH”, ka paraqitur propozimin për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm / faturave nr.INV008 e datës 27.07.2022, nr.INV016 e datës 03.11.2022, dhe nr. INV017 e datës 03.11.2022, për pagesën e borxhit në shumën prej 5.310.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet lidhur me procedurën përmbarrimore, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor me arsyetimin se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri përmbarrues nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, për faktin se fatura për t'i plotësuar kërkesat e dokumentit të besueshëm sipas LPP-së, duhet vërtetuar se fatura është lëshuar në mënyrë të rregullt, i është dorëzuar debitorit në mënyrë të rregullt duke konfirmuar këtë edhe me nënshkrimin e debitorit, të vërtetohet se shërbimi apo malli për të cilin lëshohet kjo faturë është kryer apo dorëzuar nga kreditori. Në rastin konkret, kreditori me asnjë provë nuk ka arritur ta vërtetojë asnjërin nga këto fakte me rëndësi në mënyrë që faturat e prezantuara ta marrin cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe të përshtatshëm për përmbarrim. Tutje debitori ka shtuar se faturat në bazë të të cilave është

lëshuar urdhri përmbartimor asnjëherë nuk i ka pranuar në kopje fizike nga kreditori, si dhe të njejtat në shkresat e lëndës janë vetëm faturat kopje dhe jo ato origjinale apo kopje të vërtetuara. I ka propozuar gjykatës të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa të anulohet urdhri përmbartimor P.nr.46/23 i datës 16.03.2023 të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje ndaj prapësimi të debitorit, duke kundërshtuar prapësimin e ushtruar të palës debitorë, me arsyetimin se përmbartimi është caktuar në bazë të propozimit të kreditorit dhe dokumentit përmbartimor-faturës e në përputhje me nenin 29 të LPP-së. Kreditori ka theksuar se shkaqet e prapësimi janë të parapara në mënyrë decisive me ligj, dhe debitori ne prapësimin e ushtruar nuk ka ofruar kurrfarë provash me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij dhe qëllimi është zvarritja e pagesës së borxhit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor i Përmbartuesit Privat.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.554/23 të datës 26.10.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “KiriTrees Plantage” SH.P.K, rruga “Ukshin Kovaçica” nr.11 Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.46/23 të datës 16.03.2023 të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Eset Murati, me seli të zyrës në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se fatura nr.INV008 e datës 27.07.2022, fatura nr.INV016 e datës 03.11.2022, dhe fatura nr. INV017 e datës 03.11.2022, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme sepse nuk i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet qe kërkohe me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është

treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”. Andaj edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se faturat lëndore si dokument ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, e njëjta nuk është e vulosur e as nënshkruar nga debitori ne mënyrë qe te konsiderohet si dokument i besueshëm.

Po ashtu propozimi për përmbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbarimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

EK.nr.558/24 me datë 28.05.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti